REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.10.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.10.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "DESHISHKU GB" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Gusha Batushë", Nr. i prokurimit- 632-26-8503-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-067-521, nxjerr:

V E N D I M

1.REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "DESHISHKU GB" SH.P.K., e dt. 22.10.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Gusha Batushë", Nr. i prokurimit- 632-26-8503-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-067-521, kundër dosjes së tenderit dhe njoftimi për kontratë, të publikuara më datë, të datës 12.10.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. VËRTETOHET dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë, të publikuara më datë 12.10.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik "DESHISHKU GB" SH.P.K., e dt. 22.10.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Gusha Batushë", Nr. i prokurimit- 632-26-8503-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-067-521.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 23.10.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe, pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

Pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik nuk janë mbështetur me prova konkrete që do të dëshmonin se kërkesat për mekanizim janë vendosur me qëllim të kufizimit të konkurrencës, favorizimit të një operatori ekonomik apo diskriminimit të operatorëve të tjerë.

Kërkesat e përcaktuara në Aneksin 7 janë hartuar mbi bazën e nevojave operative dhe teknike të Autoritetit Kontraktues dhe kanë për qëllim sigurimin e kapacitetit të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të detyrohet që kërkesat teknike t'i përshtatë me mekanizimin që operatorët ekonomikë e kanë aktualisht në dispozicion ose me pajisjet që janë më të zakonshme në treg. Përcaktimi i nevojës teknike i takon Autoritetit Kontraktues, ndërsa kufizimi i tillë do të ishte i papranueshëm vetëm nëse do të ishte pa justifikim objektiv, joproporcional ose i orientuar drejt favorizimit të një operatori të caktuar. Në rastin konkret, një rrethanë e tillë nuk është dëshmuar.

Përkundrazi, kërkesat janë të përcaktuara paraprakisht, janë të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë dhe lidhen me kapacitetin teknik të kërkuar për realizimin e kontratës.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues i refuzon si të pabazuara pretendimet e Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesat për mekanizim dhe konstaton se kërkesat e përcaktuara në Aneksin 7 mbeten në fuqi.

Madje, për secilin pretendim të ngritur nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues jep sqarimet përkatëse si në vijim:

Pretendimi 1 – kërkesa nr. 2 e aneksit 7-Kamion kiper me peshë bartëse max. 830 kg

Operatori Ekonomik pretendon se përcaktimi i peshës bartëse maksimale prej 830 kg është kufizues, duke argumentuar se në treg janë më të zakonshëm kamionët me kapacitet 2,000–3,000 kg.

Autoriteti Kontraktues e vlerëson këtë pretendim si të pabazuar për shkak se përcaktimi i karakteristikës teknike të mjetit është bërë mbi bazën e nevojës operative të Autoritetit Kontraktues dhe jo mbi bazën e asaj se cilët mjete janë më të zakonshme në treg.

Autoriteti Kontraktues nuk është i obliguar që të kërkojë mjetin që është më i përhapur në treg, por mjetin që e konsideron të përshtatshëm për realizimin e nevojave konkrete të kontratës.

Në këtë rast, kapaciteti maksimal prej 830 kg është përcaktuar duke pasur parasysh nevojën për një mjet kompakt, të përshtatshëm për transportimin e sasive më të vogla të materialeve dhe për përdorim në lokacione ku manovrimi dhe qasja kanë rëndësi të veçantë.

Një mjet me kapacitet dukshëm më të madh nuk mund të konsiderohet automatikisht ekuivalent me mjetin e kërkuar vetëm për faktin se mund të transportojë më shumë material.

Kapaciteti bartës është vetëm njëra prej karakteristikave të mjetit. Në përshtatshmërinë e tij ndikojnë edhe dimensionet, manovrueshmëria, qasja në terren, pesha dhe mënyra e përdorimit.

Për këtë arsye, propozimi i OE-së që kapaciteti të rritet në 2,000–3,000 kg nuk mund të pranohet vetëm mbi arsyetimin se këta kamionë janë më të zakonshëm në treg.

Gjithashtu, pretendimi se kapaciteti prej 830 kg është i pamjaftueshëm për shkak se disa pjesë ose pajisje të mjeteve të tjera mund të kenë peshë më të madhe nuk është relevant. Nuk është përcaktuar që ky kamion duhet të përdoret për transportimin e pjesëve të eskavatorëve apo pajisjeve të tjera. Secila pajisje e kërkuar ka funksionin e saj dhe kapaciteti i një pajisjeje nuk përcakton automatikisht kapacitetin e pajisjes tjetër.

Operatori Ekonomik gjithashtu nuk ka dëshmuar se kërkesa prej 830 kg i referohet një marke, modeli ose prodhuesi të caktuar apo se është përcaktuar me qëllim të favorizimit të një operatori ekonomik.

Rrjedhimisht, kërkesa për kamion kiper me peshë bartëse max. 830 kg mbetet në fuqi dhe pretendimi i Operatori Ekonomik refuzohet si i pabazuar.

Pretendimi 2 – kërkesa nr. 7 e aneksit 7- Lugë ngarkuese e pajisur me nivelizues digjital, me peshë max. 13 t

Operatori Ekonomik pretendon se kërkesa për nivelizues digjital është e panevojshme dhe diskriminuese dhe kërkon që luga ngarkuese të zëvendësohet me grader.

Autoriteti Kontraktues e vlerëson këtë pretendim si të pabazuar për shkak se kërkesa për nivelizues digjital është përcaktuar si një funksionalitet i kërkuar i pajisjes, me qëllim të sigurimit të kontrollit dhe saktësisë gjatë punës..

Argumenti i Operatorit Ekonomik se rrafshimi dhe planifikimi realizohet më mirë me grader nuk e rrëzon kërkesën e AK-së. Autoriteti Kontraktues nuk ka pretenduar se luga ngarkuese dhe graderi janë mjete identike. Përkundrazi, kërkesa është përcaktuar pikërisht për të siguruar një pajisje me funksionalitet të caktuar, e cila mund të përdoret në kuadër të proceseve të ndryshme të punës.

Një operator ekonomik nuk mund ta zëvendësojë një pajisje të kërkuar me një pajisje tjetër vetëm mbi bazën e vlerësimit të tij se pajisja alternative është më e përshtatshme.

Zëvendësimi mund të merret në konsideratë vetëm nëse dëshmohet se pajisja alternative është teknikisht dhe funksionalisht ekuivalente dhe se përmbush të njëjtën nevojë të Autoritetit Kontraktues. Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dëshmuar një ekuivalencë të tillë.

Po ashtu, nuk është dëshmuar se kërkesa për nivelizues digjital mund të përmbushet vetëm nga një prodhues ose operator ekonomik i caktuar.

Prandaj, kërkesa është e lidhur me funksionalitetin e pajisjes dhe me nevojën operative të Autoritetit Kontraktues dhe nuk rezulton të jetë përcaktuar për qëllime diskriminuese.

Rrjedhimisht, kërkesa nr. 7 e Aneksit 7 mbetet në fuqi dhe pretendimi i Operatorit Ekonomik refuzohet si i pabazuar.

Pretendimi 3 – kërkesa nr. 8 e aneksit 7-Gjysmë-rimorkio kipper me kran, gjatësi min. 6 m, peshë bartëse max. 1.2 t

Operatori Ekonomik pretendon se kjo kërkesë është diskriminuese, favorizuese dhe e panevojshme, duke pretenduar se nevoja e saj mbulohet nga kërkesa nr. 3 për kamion kipper me kran.

Autoriteti Kontraktues e vlerëson këtë pretendim si të pabazuar për shkak se kërkesa nr. 8 është përcaktuar si një konfigurim i veçantë teknik dhe funksional. Fakti se edhe kërkesa nr. 3 përfshin një kamion kipper me kran nuk nënkupton që të dyja pajisjet janë të njëjta ose automatikisht të zëvendësueshme.

Vlerësimi i ekuivalencës së dy mjeteve nuk mund të bëhet vetëm duke u bazuar në ekzistencën e kranit. Duhet të merren parasysh të gjitha karakteristikat e mjetit, përfshirë konfigurimin, dimensionet, kapacitetin, mënyrën e përdorimit, fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë për kushtet konkrete të punës.

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar të dyja pajisjet me qëllim të sigurimit të kapaciteteve të ndryshme operative dhe nuk ekziston ndonjë bazë që AK të detyrohet të eliminojë një kërkesë vetëm për shkak se një pajisje tjetër mund të kryejë pjesërisht një funksion të ngjashëm.

Pretendimi se pajisja është e rrallë në treg gjithashtu nuk është i mjaftueshëm për të provuar diskriminim. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur prova konkrete se pajisja mund të sigurohet vetëm nga një operator ekonomik ose se specifikimi është hartuar në mënyrë të tillë që i referohet një marke, modeli apo prodhuesi të caktuar.

Vetëm fakti që një pajisje është më pak e zakonshme në treg nuk e bën automatikisht një kërkesë teknike të paligjshme.

Kurse, sa i përket pretendimit lidhur me certifikatën e regjistrimit, duhet bërë dallimi ndërmjet dokumenteve që kërkohen si dëshmi në kuadër të procedurës së prokurimit dhe detyrimeve ligjore që operatori ekonomik duhet t'i përmbushë gjatë përdorimit të mjetit.

Mospërcaktimi i një dokumenti të veçantë si dëshmi në Aneksin 7 nuk mund të interpretohet si përjashtim nga detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni tjetër në fuqi.

Nëse për mjetin konkret ekziston detyrim ligjor për regjistrim, qarkullim apo pajisje me dokumentacion përkatës, operatori ekonomik është i detyruar ta përmbushë atë detyrim.

Për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet se mospërmendja e shprehur e certifikatës së regjistrimit në këtë kërkesë krijon trajtim favorizues ose diskriminues.

Ndërsa, lidhur me pretendimin se kërkesa nr. 3 e mbulon kërkesën nr. 8, Autoriteti Kontraktues sqaron se ky pretendim nuk qëndron, pasi të dyja kërkesat i referohen mjeteve të ndryshme të mekanizimit, me konfigurime dhe karakteristika të ndryshme teknike e funksionale.

Edhe po qe se të dyja mjete mund të kryejnë një pjesë të përbashkët të funksioneve, kjo nuk do të thotë se ato janë plotësisht të barasvlershme.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dëshmuar se kërkesa nr. 3 është teknikisht dhe funksionalisht ekuivalente me kërkesën nr. 8 dhe se përmes njërit mjet mund të realizohen të gjitha funksionet për të cilat AK ka paraparë përdorimin e mjetit tjetër. Për këtë arsye, nuk ekziston bazë për largimin e kërkesës nr. 8.

Rrjedhimisht, kërkesa nr. 8 e Aneksit 7 mbetet në fuqi dhe pretendimi i Operatori Ekonomik refuzohet si i pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, bazuar në arsyetimin e mësipërm dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të Operatorit Ekonomik, vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:
Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Të gjitha palëve te interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).